



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 137, dt. 15.06.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.06.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të zbatimit "Rikualifikimi Urban i Sheshit "Skënderbej", Tiranë, me subjekt aplikues Bashkia Tiranë me këto vërejtje:
 - Të eliminohen pemët e larta në hapësirën ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave
 - Të eliminohet gjelbërimi i lartë në aksin vizual të rrugës së "Durrësit" (duke ruajtur gjeresinë e trupit të rrugës) në drejtim të sheshit Skënderbej
 - Të eliminohet gjelbërimi i lartë në aksin vizual të rrugës së "Kavajës" (duke ruajtur gjeresinë e trupit të rrugës) në drejtim të sheshit Skënderbej
 - Shtrimi i sheshit para Xhamisë së Et'hem Beut të jetë uniform me shtrimin e pjesës tjetër të Sheshit Skënderbej
 - Shkallët e Muzeut Kombëtar të rikonceptohen në mënyrë asimetrike
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI